



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 274 Akti

Nr. 314 Vendimi
Tiranë, më 16.11.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Gerrit Sprenger, në datën 13.11.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Dorina Bejko**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”:

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, me detyrë prokurore/drejtuese, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.9.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioner Roland Ilia. Me vendimin nr. 24, datë 10.4.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos zëvendësimi për arsye objektive, i relatores Alma Faskaj, me komisioneren Suela Zhegu, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me këtë subjekt. Subjekti i rivlerësimit u njoh në datën 20.4.2020 me ndryshimin e anëtares dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarin, komisioneren Suela Zhegu. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën me nr. *** prot., datë 25.2.2019.

- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Dorina Bejko”.

7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 17.9.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Me vendimin nr. 3, datë 28.9.2020, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ, për subjektin znj. Dorina Bejko, vetëm për kriterin e pasurisë. Në datën 30.10.2020 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, si dhe me rezultatet e hetimit shtesë.

Për një proces të rregullt ligjor, znj. Dorina Bejko, i janë garantuar të drejtat, si: për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

11. Znj. Dorina Bejko, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datat 25.9.2020 dhe 5.11.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në

² Me nr. **** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.4.2019.

³ Me shkresën nr. **** prot., datë 12.6.2019, dërgohet raporti i KLP-së.

prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 9.11.2020.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 13.11.2020, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë, *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimit të pasurisë; kontrollit të figurës; dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, ka filluar detyrën në datën 14.11.2007, duke u bërë subjekt deklarues në vitin 2007 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private për vitet 2007 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

I. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti ka deklaruar:

1. Likuiditete në shumën 5.300.000⁴ lekë

Burimi i krijimit: krijuar nga shitja e pasurisë me nr. ****, z. k. ****, S, Tiranë (apartament me sip. 72 m² dhe 32 m² verandë), me kontratën me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 12.06.2012.

Deklarimi në DPV⁵/2012: shuma monetare përfutur nga shitja e pasurisë me nr. *****, z. k. ****S, Tiranë (apartament me sipërfaqe 72 m²).

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Për likuiditetet e deklaruara në deklaratën *Vetting*, Komisioni verifikoi dhe hetoi për:

- vërtetësinë e deklarimeve të subjektit; si dhe
- burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeve.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit ka rezultuar se këto likuiditete janë deklaruar në DPV-në e vitit 2012, me burim nga shitja e pasurisë apartament, i ndodhur në S

, Tiranë, pasuri kjo e shitur në vitin 2012, sipas kontratës së shitjes.

Në lidhje me këto likuiditete subjekti ka shpjeguar se: “*Shuma prej 5.300.000 lekësh është pakësuar ndër vite duke u përdorur, si më poshtë:*

- për blerjen e automjetit të markës “A” A**, për kryerjen e investimeve për rikonstrukcion në shumën 500.000 lekë në banesën e tyre, në fshatin B, Pogradec;
- për dhënien hua në shumën 600.000 lekë kumatës sime, V.M;
- për depozitën bankare në emër të bashkëshortit në Union Bank në shumën fillestare 1.500.000 lekë, etj. Pjesa takuese 50% unë, 50% bashkëshorti, pasi shitja është bërë gjatë martesës”.

Komisioni ka konstatuar se shuma prej 5.300.000 lekësh, e deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk disponohet nga subjekti në momentin e deklarimit, pasi nga verifikimi i

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitjeje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012 për apartament me sip.72 m², në S, Tiranë.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.7.2012
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2017, me deklaruese F.B, deklarën se në datën 7.9.2005 me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., ka shitur pasurinë nr. ****, z. k. ****, në Pogradec në çmimin 1.950.000 lekë. Shumën e lekëve të përfuturara nga shitja ja ka dhuruar djalit të saj, S.Z.B menjëherë pas shitjes së pasurisë. Bashkëlidhur kontratë shitblerje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol, datë 7.9.2005.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000. Pasuria nr.***, z. k. ****, vol.**, f. ****, lloji tokë arë me sip. 297 m². Palë shitëse trashëgimtarët e Z.B: F. B, P.B, S.B dhe V. B, palë blerëse I. B. Vlera e shitjes: 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000. Pasuria nr. ****, z. k. ****, vol. **, f. ****, lloji tokë arë me sip. 400 m². Palë shitëse F.B, P.B, S.B, I. B dhe V.B, palë blerëse C.M. Vlera e shitjes: 400.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000. Pasuria nr. ****, z. k. ****, vol.**, f. ****, lloji tokë arë me sip. 270 m². Palë shitëse trashëgimtarët e Z.B: F.B, P.B, S. B, I. B dhe V.B, palë blerëse R.P. Vlera e shitjes: 729.000 lekë.
- Akt për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. **** rep., nr. **** kol., datë 16.6.2004. Palë shitëse I.B dhe S.B, palë blerëse A.C. Truall me sip. 1.000 m², lagjia Nr. *, Rr. “D. P”, Pogradec, në vlerën 10.000 lekë /m². Për të garantuar ekzekutimin e kontratës, palët bien dakord që të paguhet si kapar shuma 5.000.000 lekë me redaktimin e kontratës. Pjesa tjetër brenda datës në të cilën do të bëhet dhe regjistrimi i pasurisë së kthyer nga KK Pronave ku do të redaktohet dhe kontrata e shitblerjes.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2017. Deklaruesi S. B ka deklaruar se në datën 12.6.2012 ka shitur pasurinë nr. ****, në S, Tiranë në vlerën 5.300.000 lekë. Nga shuma e përfutur nga shitja, një pjesë të saj, shumën 600.000 lekë ja ka dhënë hua motrës së tij, znj. V. M.
- Nxjerrje llogarie nga “Union Bank” ku konfirmohet depozitimi në *cash* në shumën 1.495.860 lekë në datën 19.12.2012 me përshkrimin: “Depozitim euro-lekë me kurs pref. 139.8. Burimi i të ardhurave nga shitje prone”.

⁵ Deklarime periodike vjetore, këtu e në vijim referuar si “DPV”.

deklarimeve periodike subjekti ka deklaruar pakësimin e tyre në vite. Për këtë shkak, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklarim të pasaktë të gjendjes së likuiditeteve.

Për këtë konstatim të Komisionit, subjektit i'u kërkua të japë shpjegime.

1.2 Qëndrimi i subjektit

Në prapësime të rezultateve të hetimit të datës 25.9.2020 dhe 5.11.2020, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se kjo shumë nuk duhet të ishte deklaruar te rubrika e pasurive, si pasuri që posedohej në momentin e deklarimit në deklaratën *Vetting*, fakt të cilin e ka pranuar se është një pakujdesi në plotësimin e formularit përkatës. Shuma prej 5.300.000 lekësh është deklaruar në DPV-në e vitit 2012 në mënyrë të saktë duke specifikuar burimin e saj që ka rezultuar nga shitja e shtëpisë, si dhe në vijim është deklaruar në mënyrë të saktë dhe pakësimi i kësaj shume.

- ✓ Trupi gjykues vlerësoi me objektivitet shpjegimet e subjektit dhe përfundimisht deklarimet e subjektit u vlerësuan si pasaktësi në plotësimin e deklaratës, pa një ndikim negativ në vlerësimin e subjektit.

Komisioni ka hetuar burimin e krijimit të likuiditeteve në shumën 5.300.000 lekë.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, likuiditetet në shumën 5.300.000 lekë, janë krijuar me burim nga shitja e apartamentit në Tiranë, ku sipas “kontratës së shitjes me rezervë” me nr. *** rep., nr. **** kol., datë 12.6.2012, ku citohet se nga çmimi i shitjes në shumën 5.300.000 lekë, është paguar *cash* në dorë 25% e shumës, e barabartë me 1.325.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 3.975.000 lekësh do t'i likuidohet palës shitëse me miratimin e kredisë së akorduar blerësve.

Me cilësinë e shitësit të pasurisë, bashkëshorti i subjektit ka lëshuar deklaratën noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 30.7.2012, ku deklaroi se ka marrë shumën prej 30.000 euro, e cila ka kaluar nga “Societe Generale Albania”, nëpërmjet kredisë bankare që i është lëvruar blerësve të apartamentit.

Pasuria apartament në Tiranë ka rezultuar të jetë blerë në vlerën 2.900.000 lekë, nga bashkëshorti i subjektit, z. S. B, me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.9.2007. Pavarësisht faktit që subjekti ka filluar detyrën e prokurores në nëntor të vitit 2007, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të paraqesë dokumentacion provues mbi burimet e ligjshme të bashkëshortit, që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës si prokurore dhe me të ardhura të akumuluar nga bashkëshorti përpara martesës, kryesisht të krijuara nga shitja e pasurive të paluajtshme të tij, të trashëguara nga babai i tij. Sipas certifikatës së martesës subjekti ka lidhur martesë në datën 16.7.2007, ndërsa referuar kontratës së shitblerjes, apartamenti është blerë në datën 13.9.2007, në shumën 2.900.000 lekë.

Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi pasuri të paluajtshme të shitura, ku bashkëshorti i saj, ka qenë në bashkëpronësi me 1/5 pjesë takuese, si më poshtë:

- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. **** në emër të shtetasve F.B, S.B, P. B, S. B, I. B dhe V.B lëshuar në datën 28.1.2000. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 28.1.2000, për pasurinë nr. ***, e llojit “tokë arë” me sip. 297 m². Palë shitëse trashëgimtarët e Z. B: F.B, P.B, S.B dhe V.B, palë blerëse I.B. Vlera e shitjes: 100.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. *** në emër të shtetasve F. B, S.B, F.B, P. B, S.B, I.B dhe V.B lëshuar në datën 28.1.2000. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000, për pasurinë nr. ***, e llojit “tokë arë”, me sip. 400 m². Palë shitëse: F.B, P.B, S B, I.B dhe V.B, palë blerëse: Ç.M. Vlera e shitjes: 400.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. *** në emër të shtetasve F.B, S.B, P.B, S. B, I.B dhe V.B lëshuar në datën 28.1.2000. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.1.2000, për pasurinë nr. ****, e llojit “tokë arë”, me sip. 270 m². Palë shitëse: F.B, P.B, S. B, I.B dhe V.B, palë blerëse: R.P. Vlera e shitjes: 729.000 lekë.

Në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti ka deklaruar, si më poshtë:

*“ 1. Të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti nga shumat monetare të përfituara nga shitja e pasurisë nr. ***, z. k. ****, datë 7.9.2005, në shumën 1.950.000 lekë nga vjerra e saj, F.B, shumë e cila i është dhënë burrit të subjektit (referuar edhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2017).*

*2. Shumat monetare të akumuluar nga shitjet e pasurive të paluajtshme gjatë viteve 2000, 2004 (shuma (2.750.800 lekë referuar kontratave: nr. *** rep., nr. ***kol., datë 18.1.2000; nr.*** rep., nr. *** kol., datë 18.1.200; nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000; dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004; si dhe*

3. Nga emigracioni sezonal i bashkëshortit në shtetin grek (vitet 1994-1999).”

Nga verifikimi i deklarimeve të mëparshme, në DPV-të para fillimit të detyrës në vitin 2007, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë apartament:

- të ardhurat janë siguruar nga shitja e pasurisë së paluajtshme, truall;
- diferenca e shumës është siguruar nga të ardhurat nga emigracioni për periudhën 1991 – 2004, në shtetin grek.

Nga verifikimi i deklarimeve ka rezultuar se deklaratimet e subjektit nuk përputhen në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë apartament, të blerë nga bashkëshorti i subjektit.

Subjekti në prapësime të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se kjo mospërputhje ka ndodhur për shkak se deklarata e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2007, është deklarata e parë e përpiluar nga bashkëshorti dhe mospasqyrimi i të gjitha të ardhurave të përdorura duhet të konsiderohet si gabim në plotësimin për herë të parë të kësaj deklarate. Subjekti ka shpjeguar se të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme të bashkëshortit gjatë vitit 2000 – 2004, janë përdorur për blerjen e kësaj pasurie dhe po të verifikohen të gjitha deklaratimet që kanë bërë subjekti dhe bashkëshorti në vite, nuk rezultojnë që këto të ardhura të jenë përdorur për ndonjë investim tjetër.

Komisioni vlerëson se mospërputhja lidhur me burimet e krijimit është bazuar mbi fakte dhe ngjarje që kanë ndodhur përpara se subjekti të kishte martesë me bashkëshortin, dhe për këtë shkak deklaratimet e subjektit janë mbështetur mbi fakte të pohuara nga bashkëshorti dhe familjarë të tij.

Në lidhje me burimet për blerjen e apartamentit, u administrua dokumentacioni, si më poshtë:

- Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.9.2005, për shitjen e pasurisë me sip. 882.5 m², me nr. ***, z. k. ***, në Pogradec, me çmimin e shitjes 1.950.000 lekë, nga znj. F. B (nëna e bashkëshortit).
- Deklaratë noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 20.1.2017, ku deklaruesja F.B, deklaroi se në datë datën datë 7.9.2005 me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.9.2005, ka shitur pasurinë nr. ***, z. k. ****, në Pogradec, në çmimin 1.950.000 lekë. Shumën e lekëve të përfituara nga shitja ia ka dhuruar djalit të saj, z. S.Z.B, menjëherë pas shitjes së pasurisë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.1.2000, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, lloji “tokë arë”, me sip. 297 m². Palë shitëse trashëgimtarët e Z.B: F.B, P.B, S.B dhe V. B, palë blerëse: I. B. Vlera e shitjes: 100.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 18.1.2000, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji “tokë arë”, me sip. 400 m². Palë shitëse: F.B, P.B, S.B, I.B dhe V.B, palë blerëse: C.M. Vlera e shitjes: 400.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 18.1.2000, pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, lloji “tokë arë”, me sip. 270 m². Palë shitëse trashëgimtarët e Z.B: F.B, P.B, S.B, I.B dhe V.B, palë blerëse: R.P. Vlera e shitjes: 729.000 lekë.
- Akt për sigurimin e ekzekutimit të kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, me palë shitëse I.B dhe S.B, palë blerëse A. C. Truall me sip. 1.000 m², lagjja Nr. *, Rr. “D.P”, Pogradec, në vlerën 10.000 lekë /m². Për të garantuar ekzekutimin e kontratës, palët bien dakord që të paguhet si kapar shuma 5.000.000 lekë me redaktimin e kontratës. Pjesa tjetër brenda datës në të cilën do të bëhet dhe regjistrimi i pasurisë së kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave ku do të redaktohet dhe kontrata e shitblerjes.

Komisioni analizoi dokumentacionin mbi burimet për blerjen e apartamentit në shumën prej 2.900.000 lekësh.

i. Komisioni, në vlerësim të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, ka konkluduar se të ardhurat nga shitja e pasurisë sipas kontratës se shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.9.2005, në shumën 1.950.000 lekë, është burim i ligjshëm dhe duke marrë në konsideratë marrëdhëniet e ngushta familjare (nënë e bir), si dhe faktin që bashkëshorti i subjektit në këtë periudhë ka jetuar së bashku me nënën (sipas certifikatës familjare),

- ✓ **këto shuma janë konsideruar si burime të mundshme për blerjen e pasurisë apartament në S, Tiranë.**

ii. Të ardhurat e përfituara me aktin për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. **** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, me vlerë kapari prej 5.000.000 lekësh. Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është një nga pasuritë e trashëguara nga babai dhe ku bashkëshorti i subjektit paraqitet me 1/5 pjesë takuese. Nga kjo shumë bashkëshorti i subjektit, ka përfituar pjesën e tij dhe të nënës, në total 2/5, pra, shuma e përfituar 2.000.000 lekë.

Komisioni i ka kërkuar subjektin informacion dhe dokumentacion për të identifikuar pasurinë e shitur, me sipërfaqe truall prej 1.000 m², ku bashkëshorti i subjektit ka qenë në cilësinë e bashkëpronarit me vëllanë e tij.

Subjekti ka shpjeguar⁶ se: “Pasuria e llojit truall me sipërfaqe 1.000 m², për të cilën është disponuar në aktin noterial, “Akt për sigurimin e ekzekutimit të kontratës”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, ka qenë një ndër pasuritë e trashëguara në mënyre ligjore nga babai i bashkëshortit të ndjerit Z. H.B..... Me vendimin nr. **, datë 9.7.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Korcë, trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Z.B i’u janë njohur dhe kthyer fillimisht sipërfaqja prej 11.010 m², pjesë e të cilës ka qenë edhe pasuria truall me sipërfaqe 1.000 m² që i ishte premtuar për t’u shitur shtetasit A.C nëpërmjet aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004.

Trashëgimtarët kanë rënë dakord që pasurinë e llojit truall me sipërfaqë 1.000 m² që i ishte premtuar për t’u shitur në datën 16.6.2004 shtetasit A.C të regjistrohej në emër të z. I. B. Ky veprim është kryer me dakortësinë e gjithë trashëgimtarëve ligjore dhe me arsyen e vetme që veprimet në vazhdimësi për përpilimin e aktit formal të shitblerjes së pasurisë të kryheshin vetëm nga z. L.B.

Pasuria e llojit truall me sipërfaqe 1.000 m² që i ishte premtuar për tu shitur u regjistrua në ZVRPP-në Pogradec në datën 10.12.2004 në emër të z. I. B si pasuria me nr. ***.

Nga shitja e pasurisë sipas Aktit për sigurimin e ekzekutimit të kontratës bashkëshorti i subjektit ka përfituar nga shuma monetare prej 5.000.000 lekë që është paguar nga blerësi z. A.C në datën 16.06.2004 vetëm 2/5 pjesë takuese (2.000.000 lekë) duke përfshirë edhe pjesën takuesë të nënës së tij znj. F. B, sikurse ajo ka deklaruar edhe në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 19.12.2019.

Referuar deklarimeve të familjarëve të bashkëshortit dhe deklarimeve të blerësit z. A.C, të pasqyruara përkatësisht në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2020, dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. ****kol., datë 15.10.2020, rezulton se çmimi total i shitjes së kësaj pasurie ka qenë 5.500.000 lekë, dhe kjo shumë është pasqyruar në aktet noteriale përkatëse e ndarë në dy pjesë, 5.000.000 lekë në aktin "Akt për sigurimin e ekzekutimit të kontratës", nr. *** rep., nr.*** kol., të datës 16.6.2004 dhe 500.000 lekë në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.12.2004.

Shuma prej 5.000.000 lekësh është ndarë ndërmjet të pestë trashëgimtarëve ligjore në 1/5 pjesë takuese, ndërsa shuma tjetër prej 500.000 lekë që i është paguar z. L.B nga blerësi z. A.C, një ditë para se të nënshkruhej kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë

⁶ Në përgjigje të pyetësorit të datës 12.10.2020, protokolluar me nr. ***, datë 7.10.2020.

14.12.2004, është marrë vetëm nga z. L.B dhe është përdorur vetëm nga ai për shpenzimet e procedurave të regjistrimit të kësaj pasurie të paluajshme dhe pagimin e detyrimeve ligjore ndaj shtetit.

Pasqyrimi i shumës monetare 500.000 lekë si çmim i shitjes së pasurisë nr. ***me sipërfaqe 1000 m² në kontratën nr. ***rep., nr. *** kol., datë 14.12.2004, është një formulim i gabuar nga ana e noterit sepse kjo shumë ka qënë vetëm diferenca e çmimit total të shitjes 5.500.000 që është paguar nga blerësi...”.

Komisioni, pas analizimit të akteve të depozituar nga subjekti, vëren se:

- Me vendimin nr. **, datë 9.7.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Korçë familjes së z. Z. B i janë kthyer nga pasuritë e trashëguara 11.010 m² tokë, në Pogradec. Bashkëlidhur, gjendet një vërtetim nga dokumenti hipotekor me datë 17.9.2004, sipas të cilës 5 anëtarët e familjes B, kanë në pronësi në mënyrë të barabartë sipërfaqen prej 11.010 m².
- Në momentin e nënshkrimit të aktit noterial për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. **rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, pasuria me sip 1.000 m², ka qënë pasuri e pa kthyer e cila me vendimin nr. **, datë 9.7. 04, të KKKP-së, i është njohur të gjithë trashëgimtarëve të z. Z. B si pjesë e pasurisë me sip. 11.010 m². Nga ana e Komisionit është e paqartë se përse akti noterial për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, është nënshkruar vetëm nga z. I dhe S. B, duke qënë se kjo pasuri i takonte dhe 3 trashëgimtarëve të tjerë.
- Trashëgimtarët e z. Z.B me aktin e pjestimit vullnetar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2004, kanë bërë pjestimin e pasurisë të njohur dhe kthyer me nr. ***, z. k. ***, me sip. 11.010 m². Nga ky akt vullnetar, sikurse ka shpjeguar dhe subjekti rezulton se shtetasit I.B, i ka takuar një sipërfaqe trualli prej 1.000 m². Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka bashkëlidhur dhe kontratën e shitblerjes së pasurie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2004, i cili pasurinë me sip. 1.000 m² ia shet shtetasit A.C, në çmimin 500.000 lekë. Në këtë akt, nuk referohet asgjë në lidhje me aktin noterial për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, apo me shumën e marrë paraprakisht prej 5.000.000 lekësh, nga shitësit e pasurisë.
- Gjithashtu, referuar aktit noterial për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, është parashikuar se: “Shitësit kanë rënë dakord që t’i shesin blerësit një sipërfaqe prej 1.000 m², dhe çmimi i shitjes do jetë 10.000 lekë/m²”. Sipas këtij akti çmimi total për shitjen e pasurisë do ishte 10.000.000 lekë. Po t’i referohemi këtij akti dhe kontratës se shitblerjes së pasurisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2004, me të cilin subjekti pretendon se është shitur kjo pasuri, rezulton se nuk përputhet çmimi. Gjithashtu, në kontratën e shitblerjes, nuk i bëhet referencë aktit noterial për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2004, me të cilin ishin paguar pjesa më e madhe e çmimit të shitjes së pasurisë.

- Pas pjestimit vullnetar që i'u bënë pasurive nga trashëgimtarët e z. Z.B, kontrata e shitblerjes, së pasurisë prej 1.000 m², është nënshkruar nga z. I.B, si titullar i vetëm i pasurisë, te blerësi A. C dhe ky fakt nuk lidhet me bashkëshortin e subjektit.
- Në bazë të pjestimit vullnetar të pasurive që ka bërë familja B, bashkëshorti i subjektit, z. S. B, bashkë me trashëgimtarët e tjerë kanë përfituar pasuri të tjera.

Referuar aktit të shitjes, Komisioni vëren se me cilësinë e shitësit të kësaj pasurie ka vepruar z. I.B (vëllai i bashkëshortit të subjektit).

- Referuar akteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk provohet që bashkëshorti i subjektit, z. S. B, të ketë përfituar të ardhurave nga shitja e pasurisë në emër të z. I.B.

Për sa më sipër, shuma e pretenduar si e përfituar nga shitja e pasurisë me sip. 1.000 m², nuk u konsiderua si burim krijimi për këtë pasuri dhe nuk u përfshi as në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

iii. Si burim i tretë i deklaruar nga subjekti për blerjen e apartamentit në Tiranë, janë deklaruar gjithashtu dhe të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, nga emigracioni në shtetin Grek.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, ka rezultuar se për të ardhurat e pretenduara si të fituara nga punësimi në shtetin grek, nuk provohet të jenë paguar detyrimet tatimore, në përputhje të parashikimeve ligjore.

Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me dy burimet e fundit të krijimit të pasurisë, i kërkoi subjektit të jepte shpjegime për të provuar të kundërtën.

1.3 Qëndrimi i subjektit

Në prapësime të rezultateve të hetimit, në lidhje me burimin e dytë për blerjen e apartamentit në Tiranë, me të ardhurat e përfituara nga akti për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. *** rep., datë 16.6.2004, me vlerë kapari 5.000.000 lekë, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato gjatë hetimit të kryer nga Komisioni.

Subjekti ka argumentuar se sikurse është provuar gjatë hetimit por dhe me shpjegimet e depozituara prej saj pasuria me sipërfaqe prej 1.000 m², ishte një pasuri në bashkëpronësi të të gjithë trashëgimtarëve ligjor, e regjistruar si bashkëpronësi referuar vërtetimit hipotekor, datë 17.9.2004, me 1/5 pjesë takuese për secilin trashëgimtar ligjor. Në të gjitha rastet pas vitit 2000, veprimet për shitjen e pasurive në bashkëpronësi, nuk janë kryer nga të gjithë bashkëpronarët e pasurisë, për shkak të marrëdhënieve të posaçme të vllazërisë, por janë autorizuar për të vepruar vetëm dy prej tyre S (bashkëshorti) dhe I. B (vëllai i tij). Për këtë arsye është vijuar me shitjen e pasurisë vetëm nga z. I.B, fakt i cili nuk është kontestuar as në atë kohë dhe as më vonë nga bashkëpronarët e tjerë.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur nga ana e z. I.B, me redaktimin e kontratës së shitblerjes është paguar vetëm një pjesë e detyrimit tatimor, janë marrë masa dhe është shlyer

edhe pjesa tjetër e detyrimeve tatimore, duke shlyer plotësisht pagesën e detyrimit për çmimin e plotë të blerjes së pasurisë, sipas kërkesave të ligjit, referuar mandatpagesës⁷ së datës 5.11.2020.

Në lidhje me burimin e tretë, të ardhurat e përfituara në emigracion, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek me dokumentacion të rregullt qëndrimi. Referuar legjislacionit përkatës, detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale e ka pasur punëdhënësi në shtetin grek, dhe në kushtet pandemisë botërore është momentalisht e pamundur që të aksesohet dokumentacioni i nevojshëm. Subjekti ka shpjeguar se Komisioni në vlerësimin e kësaj situatë duhet të ketë në konsideratë që të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti janë të periudhës 1998 - 2000, ndërsa subjekti ka lidhur martesë në korrik të vitit 2007 dhe ka filluar detyrën e prokurores në nëntor të vitit 2007.

1.4 Arsyetimi ligjor

Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit të depozituara në datën 25.9.2020 dhe 5.11.2020, bazuar edhe në dokumentacionin e depozituar në dosje, arsyeton se:

- Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga akti për sigurimin e ekzekutimit të kontratës nr. ***rep., datë 16.6.2004, çmon se këto të ardhura janë të ardhura të krijuara në mënyrë të ligjshme pasi janë përfituar nga shitja e një pasurie e cila ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe të familjarëve të tij dhe të ardhurat janë ndarë ndërmjet të gjithë bashkëpronarëve. Në vijim të këtij argumenti, subjekti ka depozituar dhe deklaratat noteriale të bashkëpronarëve të tjerë të pasurisë të cilët konfirmojnë këtë fakt.

Komisioni arsyeton se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe arrin në përfundimin se të ardhurat që janë përfituar nga shitja e kësaj pasurie sipas pjesës takuese që ka pasur bashkëshorti i subjektit, kanë shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament blerë në Selitë, Tiranë.

- Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga emigracioni në shtetin grek, Komisioni arsyeton se subjekti ka mundur të provojë që ka punuar dhe ka qenë me leje qëndrimi të rregullt. Por nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, për efekt të analizës financiare nuk u provua me dokumentacion ligjor, pagimi i tatimit në burim për të ardhurat e përfituara.

Për sa më sipër, trupi gjykues në situatën objekt vlerësimi i jep rëndësi fakteve objektive dhe ligjore që janë të lidhura me: (a) faktin se burimet që janë përdorur për krijimin të kësaj pasurie janë krijuar përpara martesës së subjektit me bashkëshortin; (b) faktin se në kohën kur janë përfituar këto të ardhura, z. S.B nuk e gëzonte statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe aq më pak statusin e personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (c) faktin se kur janë krijuar këto burime por dhe kur është blerë pasuria apartament, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e prokurores; si dhe (d) faktin se bashkëshorti i subjektit ka depozituar dokumentacion ligjor dhe ka provuar se ka disponuar të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament.

⁷ Prova të depozituara nga subjekti në seancën dëgjimore të datës 13.11.2020.

Trupi gjykues ka konkluduar se subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor se bashkëshorti ka pasur të ardhura të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë apartament në Selitë, Tiranë. Problematikat dhe pasaktësitë që kanë rezultuar nuk e penalizojnë subjektin, për faktin se krijimi i të ardhurave dhe blerja e pasurisë apartament, janë veprime që kanë ndodhur përpara se subjekti të merrte detyrën e prokurores dhe deklaratimet e saj janë mbështetur mbi bazën e konfirmimeve të dhëna nga bashkëshorti dhe familjarë të tij.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga dosja e ILDKPKI-së, referuar kartelës së pasurisë për apartamentin në Tiranë, nga aktet ka rezultuar që kjo pasuri është rivlerësuar dy herë nga bashkëshorti i subjektit.

Duket i paqartë rivlerësimi i dytë i apartamentit nga rivlerësimi i parë me vlerë 5.097.600 lekë, në të dytin në vlerën 7.119.600 lekë, në datën 6.6.2012. Në lidhje me këtë konstatim Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti në lidhje me rivlerësimin e pasurisë apartament me sip. 72 m² në datën 24.4.2012 në shumën 5.097.600 lekë dhe në datën 6.6.2012 në shumën 7.119.600 lekë, ka shpjeguar se ky apartament, është rivlerësuar nga bashkëshorti i saj vetëm një herë, në datën 24.4.2012, në shumën 5.097.600 lekë. Ky fakt rezulton nga përmbajtja e kopjes së kartelës së pasurisë që shoqëron kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, si dhe nga përmbajtja e kontratës së shitjes me nr*** rep., nr. ***kol., datë 12.6.2012, dokumente të cilat i kam vënë në dispozicion të ILDKPKI- së dhe të Komisionit. Në të dyja këto dokumente evidentohet qartazi fakti se në momentin e shitjes kjo pasuri ka pasur të pasqyruar rivlerësimin e kryer nga bashkëshorti i subjektit në datën 24.4.2012, në shumën 5.097.600 lekë, përkatësisht në rubrikën “përshkrime të veçanta” të kopjes së kartelës të rifreskuar në datën 12.6.2012 dhe në përshkrimin e pasurisë në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012.

Konstatimi se për këtë pasuri është kryer një rivlerësim i dytë në datën 6.6.2012, në shumën 7.119.600 lekë, përmban të dhëna të gabuara, rivlerësim i cili nuk bazohet në asnjë akt të administruar në dosjen e pronës përkatëse pranë ASHK-së. Subjekti, në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 84/2012, ka depozituar përpara Komisionit aktet shpresore provuese, ku konfirmohet rivlerësimi i kryer, data përkatëse, si dhe vlera e pronës, duke kërkuar që sa më sipër të mbahet parasysh nga Komisioni për qartësimin e situatës.

Komisioni vlerëson se subjekti me shkresën e depozituar nr. *** prot., datë 21.9.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë, konfirmon se pasuria apartament me nr. ****, z. k. *** vol. ***, është rivlerësuar nga z. S.B në datën 24.4.2012. Nga kjo shkresë rezulton se më pas kjo pasuri i është shitur blerësave z. B. B dhe bashkëshortes së tij. Blerësit e kanë rivlerësuar pasurinë sërish në datën 24.5.2017, dhe më pas e kanë shitur te një shtetas tjetër.

Nga praktika, ka rezultuar se nga bashkëshorti i subjektit kjo pasuri është rivlerësuar vetëm një herë në datën 24.4.2012.

- ✓ Për sa më sipër, pretendimet e subjektit, janë konfirmuar nga ASHK-ja Tiranë dhe, për pasojë, Komisioni i konsideron shpjegimet e subjektit si bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues, në përputhje me pikën 3, të nenit D të Kushtetutës.

2. Automjet⁸ tip “A” A*”, blerë në datën 24.5.2012, në shumën 7.000 euro.

Burimi i krijimit: blerja e automjetit është siguruar nga parapagesa e kryer për shitjen e pasurisë apartament me sip. 72 m², nr. ***, z. k. *** S, Tiranë, likujduar *cash* nga shitësi në shumën 1.325.000 lekë.

Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi me bashkëshortin 50% secili.

Deklarimi në DPV⁹: subjekti ka deklaruar si burim parapagesën e kryer për shitjen e pasurisë apartament, në S, Tiranë.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes, datë 24.5.2012.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRR-ja¹⁰, ka konfirmuar se automjeti me targa AA *** EA, është në bashkëpronësi të shtetasve D dhe S.B. Në dosje është administruar kontratë shitblerje automjeti, datë 24.5.2012, me palë shitëse G. A dhe palë blerëse D. B dhe S.B në shumën 7.000 euro.

2.2 Burimi i krijimit

Subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë me të ardhurat e siguruar nga parapagesa e kryer për shitjen e pasurisë me nr.***, z. k. *** S, Tiranë (apartament me sip 72 m²), në shumën 1.325.000 lekë.

Referuar akteve të administruara, ka rezultuar se kontrata e shitblerjes për shitjen e apartamentit është nënshkruar në datën 12.6.2012, ndërkohë që automjeti është blerë me kontratën e shitblerjes së datës 24.5.2012.

Gjatë hetimi shtesë, subjekti ka shpjeguar¹¹ se: *“Parapagesa e kryer nga blerësit në shumën 1.325.000 lekë, sipas kontratës së shitjes me rezervë për apartamentin prej 72 m², në S, Tiranë, i është kryer bashkëshortit nga z. B.B në javën e parë të muajit maj 2012.*

Në momentin e shlyerjes së kësaj pagese, midis palëve nuk është përpiluar akt noterial. Kjo për shkak se ishte rënë dakort që pagesa të përmendej në aktin noterial përfundimtar të shitjes së apartamentit si dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme shoqërore që familja jonë ka pasur me blerësit e apartamentit, (konkretisht me bashkëshortin e z. B.B, znj. R. M kemi qenë shoqe gjatë studimeve në Fakultetin e Drejtësisë dhe në vazhdim gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës).

⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

leje qarkullimi automjeti me targa AA *** EA në emër të z. S.B; certifikatë pronësie mjeti rrugor me targa AA *** EA, nr. shasie *****, lëshuar në datën 17.7.2012; kontratë shitblerje për automjetet e përdorura, datë 24.5.2012, palë shitëse G.A, palë blerëse D. B dhe S. B; automjet audi nr. shasie ***** në vlerën 7.000 euro; Faturë pagese në “Raiffeisen Bank”, datë 13.7.2012, në favor të zyrave doganore me përshkrimin e veprimit “zhdoganim X”, në shumën 204.898,98 lekë.

⁹ E vitit 2012

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2019.

¹¹ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 1.10.2020, protokolluar me nr. *****, datë 7.10.2020.

*Pagesa në vlerën përkatëse, është përmendur dhe është bërë pjesë e aktit noterial, të nënshkruar midis palëve, pa asnjë vërejtje apo shënim referuar kësaj pagese, konkretisht në aktin noterial kontratë shitje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, të përpiluar përpara noterit publik, ku është përcaktuar shlyerja e pagesës në shumën 1.325.000 lekë si dhe mënyra e pagesës në cash.*

Për shkak se blerësi z. B.B është resident familjarisht prej disa vitesh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kam mundur të siguroj vetëm një email të dërguar nga ai për të provuar momentin e dhënies cash të shumës monetare 1.325.000 lekë , e-mail të cilin ua vë në dispozicion.

*Po kështu, iu vë në dispozicion një deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2020, të lëshuar nga bashkëshorti im, ku pasqyrohen aspekte referuar marrjes së paragesës, objekt pyetjeje nga ana juaj”.*

Referuar shpjegimeve të mësipërme, në përgjigjet e pyetësorit rezulton një e-mail i z. B. B, i cili deklaron se në javën e parë të majit të vitit 2012, ka parapaguar shumën prej 1.325.000 lekësh, për efekt të blerjes së apartamentit me nr. pasurie ***, z. k. *** S, Tiranë. Pjesa tjetër është paguar me aprovimin e kredisë bankare.

Komisioni ka vlerësuar se në kontratën e shitjes me rezervë ligjore të datës 12.6.2012, është parashikuar se: “Është likuiduar në natyrë cash në dorë 25% e kësaj shume, e barabartë me 1.325.000 lekë”. Ky parashikim në kontratë nuk referon se shuma e dhënë si parapagim t’i jetë paguar shitësve 3 javë përpara nënshkrimit të saj.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje automjeti tip “A A*” është blerë sipas kontratës së shitblerjes në datën 24.5.2012.

Sipas mandatpagesës, datë 13.7.2012, në “Raiffeisen Bank” më në favor të zyrave doganore me përshkrimin e veprimit “zhdoganim X”, në shumën 204.898,98 lekë, rezulton të jetë paguar dogana në shumën 204.468 lekë. Rezulton se subjekti kishte burime financiare për të zhdoganuar automjetin, pasi ka rezultuar i kryer pas nënshkrimit të kontratës me rezervë.

Duke qenë se burim i vetëm për blerjen e autoveturës është deklaruar shuma e parapaguar cash, Komisioni ka konsideruar si datë të pagimit të kësaj parapagese datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes më 12.6.2012, duke konstatuar se kjo parapagese nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e automjetit në datën 24.5.2012.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

2.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

i. Subjekti, në prapësimet e datës 5.11.2020, ka shpjeguar se ky automjet është blerë me shumën e parapaguar cash prej 1.325.000 lekë, dhënë nga shtetasi B.B në javën e parë të majit të vitit 2012, si paradhënie për blerjen e apartamentit. Ky veprim është konfirmuar nga blerësi, sipas deklaratës noteriale, datë 30.10.2020, të përpiluar në SHBA, ku pranohet fakti i dhënies së pagesës përkatëse, si dhe i datës së përafërt (java e parë e muajit maj 2012), duke qenë në dijeni

për pasojat ligjore që vijnë nga deklarimi i rremë në aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Ky fakt konfirmohet edhe në e-mailin e datës 5.10.2020 të z. B.B, e-mail i cili është vënë në dispozicion të Komisionit, në përgjigjet e pyetësorit. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që të vlerësojë gatishmërinë e blerësit z. B. B për të komunikuar dhe për të shpjeguar rrethanat përkatëse me qëllim sqarimin e kësaj situatë në lidhje me shumën e paradhënies.

Subjekti ka argumentuar se blerja e automjetit dhe shitja e apartamentit janë veprime juridike të cilat janë kryer brenda një afati kohor shumë të shkurtër, prej rreth dy javësh larg njëra-tjetrës, çka tregon se burojnë nga shitja e apartamentit. Subjekti ka shpjeguar se me palët kur kanë dhënë/marrë shumën *cash* të paradhënies kanë rënë dakord që të mos përpilojnë akt tjetër noterial, por pagesa e shumës të përmendet në kontratën përkatëse, sikurse është cituar në përmbajtjen e saj. Rëndësi i është kushtuar çmimit të shitjes dhe jo momentit se kur është dhënë pagesa *cash*, duke u konsideruar nga palët si e mjaftueshme për të vërtetuar sasinë e pagesës së kryer. Kjo sjellje e palëve kontraktore justifikohet edhe për shkak të marrëdhënies së posaçme shoqërore që familja e subjektit ka pasur me blerësit e apartamentit (konkretisht, me bashkëshorten e z. B.B, zj. R.M kanë qënë shoqe gjatë studimeve në Fakultetin e Drejtësisë dhe në vazhdim gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës).

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni, që të marrë në cilësinë e provës DPV-në e vitit 2012 dhe deklaratën *Vetting*, ku për blerjen e automjetit është deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka shërbyer paradhënia e shitjes së apartamentit, dhe gjithashtu duhet të mbajë parasysh se kjo shumë është deklaruar edhe në kontratën e shitjes me rezervë nr. **** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, ku noteri specifikon se shuma prej 1.325.000 lekësh është parapaguar *cash* përpara redaktimit të kësaj kontrate.

Pavarësisht formulimit në kontratë dhe mos specifikimit të datës kur është kryer pagesa përkatëse e paradhënies, subjekti thekson se në përgjithësi të gjitha kontratat e shitblerjes, në rastin kur shumat nuk jepen në zyrën e noterit, përmbajnë përpilime standarde të tipit shuma është shlyer jashtë kësaj zyre, pa specifikuar si rregull datën kur është shlyer ajo.

2.4 Analiza ligjore

Komisioni vlerëson se subjekti, ka qënë konsistente në deklaratimet e saj, kur ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qënë me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Tiranë, si në DPV-në e vitit 2012 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.

Po t'i referohemi datave të nënshkrimit të kontratave, ajo e blerjes së automjetit është e datës 24.5.2012 ndërsa kontrata e shitblerjes me rezervë është më 12.6.2012. Referuar kontratës së shitjes me rezervë ligjore të datës 12.6.2012, është parashikuar se: “*Është likuiduar në natyrë cash në dorë 25% e kësaj shume, e barabartë me 1.325.000 lekë*”. Duke marrë në konsideratë diferencën në ditë ndërmjet 2 akteve, deklaratimeve të blerësit B.B se parapagesa është bërë në javën e parë të muajit maj, si dhe marrëdhënies së posaçme shoqërore me blerësin, Komisioni ka krijuar bindjen se kjo shumë është marrë si parapagim, duke e konsideruar si burim të ligjshëm për blerjen e automjetit.

Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit edhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, burimin e krijimit të saj, si dhe ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

3. Likuiditete *cash*¹² në shumën 9.000 euro.

Burimi i krijimit: krijuar nga tërheqja e depozitës bankare në “Union Bank” në datën 18.2.2016. Burimi i këtyre të ardhurave është shuma e shitjes së apartamentit me sip. 72 m² në datën 12.06.2012.

Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi me bashkëshortin 50 % secili.

Deklarimi në DPV/2012: në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2012 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ndër të tjera, ka deklaruar: *“Llogari kursimi në shumën 1.500.000 lekë të depozituara në ‘Union Bank’, dega Pogradec, të siguruar nga shitja e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, S, Tiranë (apartament me sip. 72 m²)”*.

Subjekti në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Shuma monetare prej 9.000 euro cash e krijuar nga tërheqja e depozitës bankare në ‘Union Bank’, datë 18.2.2016, burimi i këtyre të ardhurave është shuma e shitjes së pasurisë nr. ****, z. k. ***, S, Tiranë (apartament me sipërfaqe 72 m², nëpërmjet kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.06.2012”*.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në DPV-të periodike ka rezultuar se: në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2012, subjekti ka deklaruar llogari kursimi në shumën 1.500.000 lekë në “Union Bank”, me burim nga shitja e pasurisë apartament me sip. 72 m², në Tiranë.

Në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2014, subjekti ka deklaruar se llogaria e kursimit në “Union Bank”, e cila ka qenë në valutën lekë, është shndërruar në valutë euro dhe gjendja aktuale është në vlerën 10.500 euro (gjendja në datën 19.3.2015). Në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2015, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë 10.500 euro.

➤ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.**

4. Gjendja¹³ e likuiditeteve e mbetur në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank”, dega Pogradec, referuar *statement* të printuar nga llogaria bankare, datë 24.01.2017, në shumën 369.19 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Union Bank”, datë 11.1.2017, ku konfirmohet tërheqje nga llogaria në datën 1.2.2016 e shumës 9.000 euro.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Raiffeisen Bank”¹⁴, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse të pagës në emër të znj. Dorina Bejko me gjendje në datën 23.1.2017 në shumën 369,19 lekë.

- **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.**

PASURITË E DEKLARUARA NGA BASHKËSHORTI I SUBJEKTIT– S.B

5. Pasuria¹⁵ banesë - me sipërfaqe 40 m² dhe truall 200 m², B, Pogradec me nr. ***, z. k. *** (banesë ku jeton aktualisht subjekti).

Burimi i krijimit: përfituar me trashëgimi ligjore nga babai Z.B, sipas vendimit nr. ***, datë 1.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e regjistruar në datën 22.10.2009, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.10.2009. Kjo banesë është ndërtuar nga babai i bashkëshortit të subjektit, z. Z.B, rreth vitit 1960. Pjesa takuese: 6/15 pjesë.

Në DPV-në para fillimit të detyrës, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në pronësi shtëpi banimi me sip. 80 m², ndërtuar nga babai në vitin 1965 dhe se zotëron 2/3 e saj.

5.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZQRPP-ja¹⁶, ka konfirmuar se z. S. B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë nr. ***, vol. **, f. **, truall me sip. 200 m² dhe ndërtesë më sip. 40 m², z. k. ***, ref. ***. Referuar certifikatës së pronësisë, kjo pasuri është regjistruar në vitin 2009.

ZVRPP-ja Pogradec¹⁷, ka bashkëlidhur dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë nr. **, vol. **, f. **.

OSHEE-ja¹⁸, ka informuar se në instancën e Pogradecit, Buçimas, rezulton një kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të shtatases F. B.

Ujësjiellës Kanalizimi Pogradec¹⁹, ka informuar se në instancën e Pogradecit, rezulton klient shtetasja F.B, me nr. kontrate ***. Në arkivin e këtij institucioni nuk egziston dokumentacion shoqërues për këtë kontratë.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 24.1.2017, ku figuron gjendja e llogarisë në datën 23.1.2017 në shumën 369,19 lekë.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.6.2019.

¹⁵ Bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/9): Vendim “Në emër të Republikës” nr. **, datë 1.12.1999, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin Z.B, i vdekur në datën 14.6.1999; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë nr. ***, vol. **, f. **, z. k. *** e llojit truall me sip. 200 m², nga kjo ndërtesë me sip. 40 m². S.B është bashkëpronar me 6/15 pjesë.

¹⁶ Me shkresën nr. **** prot., datë 2.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁷ Me e-mail-in e datës 25.2.2019, drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2019.

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2019.

Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec²⁰, ka vënë në dispozicion të Komisionit, certifikatën familjare të z. Z.B, pasqyruar në regjistrin themeltar me ndryshimet vijuese, si dhe certifikatat personale të trashëgimtarëve të tij në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974.

Referuar certifikatës familjare të z. Z.B, rezultojnë 10 anëtarë, 4 fëmijë/trashëgimtarë, bashkëshortja, vëllai i ndjerë R. B, një nuse të djalit dhe 2 nipa. Nga ky akt rezulton se F e S B, janë shpërngulur në Pogradec, Z.B është çregjistruar në datën 18.6.1999, R.B (i vëllai) është çregjistruar në datën 1.6.1993, I.B ndarë nga familja më 26.5.1989, P.B (me familjen) është ndarë në datën 30.10.1979 dhe V.B (e bija) është martuar më 22. 2.1989.

Nga verifikimi i akteve depozituar nga subjekti, ka rezultuar një certifikatë familjare e datës 18.12.2012, e cila pasqyron gjendjen e familjes në datën 1.8.1991, sipas të cilës familja është e përbërë nga Z.B kryefamiljar, F.B dhe S.B. Fëmijët e tjerë, sikurse ishin shpjeguar në certifikatën familjare depozituar nga Zyrën e Gjendjes Civile, Bashkia Pogradec, rezultojnë të shkëputur nga trangu familjar i z. Z. B.

Komisioni ka pyetur subjektin në lidhje me mospërputhjen për sipërfaqen e ndërtimit dhe pjesën takuese të bashkëshortit në këtë pasuri. Subjekti ka shpjeguar²¹ se: *“Kjo shtëpi është pasuri e trashëguar nga babai i subjektit në bashkëpronësi. Kur është bërë deklarimi i parë kjo pasuri nuk ishte e regjistruar, për pasojë bashkëshorti e ka deklaruar siç mendonte pjesën takuese. Pas regjistrimit të saj, rezultoi se pasuria është ndarë në dy pasuri me nga 40 m² ndërtim dhe 200 m² truall. Sipërfaqja totale e banesës në B është 80 m², por kjo banesë tashmë rezulton e ndarë në dy pasuri:*

- *pasuria me nr. ****, me sipërfaqe 40 m² në pronësi të vëllait të bashkëshortit tim z.I. B, dhe*
- *pasuria me nr. **8, me sipërfaqe 40 m² në bashkëpronësi të bashkëshortit tim S.B dhe familjarëve të tij.”*

Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar praktikën e regjistrimit të pasurive nr. *** dhe nr. ***, që përbëjnë banesën nga ASHK-ja Pogradec, si dhe certifikatat e pronësisë.

ASH-ja Pogradec, informon se kjo pasuri ka si origjinë VKM-në nr. **, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.

Subjekti ka depozituar foto të kësaj banese.

- **Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, nuk u vërejt ndonjë pasaktësi për këtë pasuri.**

6. Pasuritë ²² e llojit, tokë arë, në z. k. *, B, Pogradec:**

- **nr. ***, tokë arë, me sipërfaqe 830m²,**
- **nr. ****, tokë arë, me sipërfaqe 950 m². Pjesa takuese: 6/15 pjesë.**

²⁰ Me shpresën nr. *** prot., datë 17.9.2019.

²¹ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 1.10.2020, protokolluar me nr. ***, datë 7.10.2020.

²² Bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/10): akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 18.11.1992, për Z.B, fshati B; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, për pasurinë nr. ***, vol. ***, f.***, z. k. *** e llojit arë me sip. 830 m². S.B është bashkëpronar me 6/15 pjesë.

6.1 Burimi i krijimit

Subjekti ka shpjeguar se këto pasuri janë përfituar nga vjerri i saj sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën bujqësore”, me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 18.11.1992, regjistruar në datën 19.12.2012, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ****, datë 19.12.2012 dhe certifikatës për vërtetim pronësie nr. ****, datë 19.12.2012.

Subjekti ka depozituar një certifikatë familjare të z. Z. B lëshuar në datën 18.12.2012, e cila pasqyron gjendjen e familjes më 1.8.1991, sipas të cilës familja është e përbërë nga Z.B kryefamiljar, F.B dhe S.B.

6.2 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZQRPP-ja²³, ka konfirmuar se shtetasi S.B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, tokë arë, me sip. 830 m², z. k. ***, ref. *** dhe pasurinë nr. ***, vol.***, f.***, tokë arë, me sip. 950 m², z. k. ***, ref. ***.

Bashkëlidhur praktikës ka rezultuar: vendimi, nr. **, datë 14.9.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënsin Z. B; libri i ngastrave; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** e llojit “arë” me sip. 830 m² (S.B është bashkëpronar me 6/15 pjesë); hartë treguese e regjistrimit; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë nr.***, vol. **, f. ***, z. k. *** e llojit “arë” me sip .950 m² (S.B është bashkëpronar me 6/15 pjesë); si dhe hartë treguese e regjistrimit.

➤ **Nga verifikimi i kryer, nuk ngrihen dyshime për këto pasuri.**

7. Pasuria²⁴ tokë truall me sipërfaqe 500 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, Pogradec, e regjistruar më 10.12.2004, referuar certifikatës për vërtetim pronësie datë 10.12.2004. Pjesa takuese: 100 %.

7.1 Burimi i krijimit

Kjo pasuri është përfituar me trashëgimi ligjore sipas vendimit nr. **, datë 1.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga vjehri i subjektit, z. Z. B, të cilit me vendimin nr. **, datë 9.7.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Korçë, i është njohur dhe kthyer kjo pronë.

7.2 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZQRPP-ja²⁵ ka konfirmuar se z. S. B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me sip. 11.010 m² truall, nr. **, vol. **, f. **, sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

²⁴ Bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip. 500 m², nr. ****, vol.***, f. **, z.k. ***, në emër të z. S.B, lëshuar në datën 10.12.2004. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimi; vendim nr. **, datë 9.7.2004, i KKKPishPronarëve Korçë, ku është vendosur: “*Trajtimi i pronës së pretenduar nga ish-pronari Z.B të njohur me vendimin nr. **, datë 8.1.1997, nga ish-KKKP, ish-pronarëve pranë ish-Këshillit të Rrethit Pogradec me sip. 36.000 m². T'u kthejë trashëgimtarëve të ish-pronarit Z.B, sip. 11.010 m², truall i lirë. Pronën e përfitojnë trashëgimtarët e ish-pronarit Z.B, F, P, S., I dhe V.B nga 1/5 pjesë e pandarë secili. Bashkëlidhur plan-vendosja e pronës*”.

²⁵ Me shkresën nr*** prot., datë 2.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

nr. **, datë 17.9.2004, për pasurinë me sip.11.010 m² truall, nr. ***, në pronësi të shtetasve F, P, S, I dhe V.B.

Nga aktet e dosjes rezulton vendimi nr. **, datë 9.7.2004, i KKKP ish Pronarëve Korçë, vendimi nr. **, datë 1.12.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, hartë treguese e regjistrimit për pasurinë nr. ***, z. k. ***, zbatim vendimi i KK Pronave nr. *** prot., datë 6.9.2004, i cili ka njohur dhe i ka kthyer ish-pronarëve sipërfaqen prej 11.010 m².

Më tej, trashëgimtarët ligjorë të z. Z.B, me vullnet, ndërmjet tyre kanë nënshkruar një akt pjesëtimi vullnetar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2004, për pasurinë me sip. 11.010 m² truall, nr. ***, z. k. ***, në Rr. "D.P", lagjja nr. **, P. Sipas këtij akti rezulton se: "... S. B do të jetë pronar i një sip. truall prej 500 m² dhe një sip. truall prej 1.701 m² ...". Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. pasurie ***, vol. **, f. **, truall me sip. 1.701 m², në emër të z. S.B (e mbyllur). Harta treguese e regjistrimit.

➤ **Nga verifikimi i kryer nuk ngrihen dyshime për këtë pasuri.**

8. Pasuri²⁶ tokë truall me sipërfaqe 180 m² dhe 115 m², ndërtesë me nr. pasurie *, e regjistruar më 14.12.2012, z. k. ***, Pogradec, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 14.12.2012. Pjesa takuese: 100 %.**

8.1 Burimi i krijimit

Subjekti, për burimin e krijimit të kësaj pasurie, ka shpjeguar se kjo pasuri është përfituar nga pjesëtimi i pasurisë në bashkëpronësi. Kjo pasuri me nr. *** ka qenë fillimisht pasuri në bashkëpronësi dhe është përfituar me trashëgimi ligjore nga vjehri, z. Z. B. Këtij të fundit, me vendimin nr. *, datë 8.1.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Pogradec dhe vendimin nr. **, datë 9.7.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Korçë, i është njohur: (i) pronësia mbi truallin; dhe (ii) e drejta e parablerjes së objektit "godina 2-katëshe e oficerëve".

Me kontratën nr. *** rep., datë 6.6.2011, trashëgimtarët ligjorë të shtetasit Z.B kanë blerë nga Ministria e Financave objektin "godina 2-katëshe e oficerëve" me sip. 900 m² truall, nga e cila 730 m² ndërtesë në vlerën 7.248.944 lekë. Kjo shumë monetare është paguar në dy mënyra: 1.449.789 lekë *cash* (më 14.10.2010, referuar mandatarëkëtimit nr. ***) dhe 5.800.000 lekë në bono privatizimi (referuar formularit për depozitim e bonove të privatizimit datë 29.12.2010).

²⁶ Bashkëlidhur deklarates: certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip. 180 m², nr. ***, vol. **, f. ***, z.k. ***, nga e cila ndërtesë me sip.115 m², në emër të z. S. B, lëshuar më 14.12.2012. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimit; vendim nr. *, datë 8.1.1997 e KKKP-së Pogradec. Në pikën 3 të vendimit është vendosur: "Ish-pronarit i njihet e drejta e parablerjes në rast privatizimi të objekteve 'R-K', për sip. 138 m² dhe godina e oficerëve 2 kat me sip. 1.452 m²; kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme e objektit "godina 2-katëshe e oficerëve" Pogradec, në varësi administrative të drejtorisë së shërbimeve qeveritare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2011. Palë shitëse Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe shitjes së pronave publike dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, palë blerëse I. B, F. B, V.M (B), S.B dhe P.B. Objekti i kontratës është kalimi në pronësi private të objektit "godina 2-katëshe e oficerëve" Pogradec, në varësi administrative të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me sip. 900 m², nga e cila 730 m² nën objekt, sipas vendimit nr. **, datë 8.1.1997 dhe vendimit nr. **, datë 9.7.2004, të KKKP-së. Numri i pasurisë është *** dhe çmimi i shitjes 7.248.944 lekë, vlerë e cila është paguar me mandatarëkëtim referenca ***, datë 14.10.2010, në shumën 1.449.789 lekë dhe formularit të bonove të privatizimit të datës 29.12.2010 për vlerën 5.800.000 lekë në bono privatizimi. Bashkëlidhur dokumentacioni për kalimin e pronësisë së objektit. Formular për kalimin e bonove të privatizimit datë 29.12.2010, e shumës 5.800.000 lekë. Formular derdhje në arkë në "Raiffeisen Bank" e shumës 1.449.939 lekë, datë 14.10.2010, nga z. I.B. Hartë treguese e regjistrimit. Kartela e pasurisë së paluajtshme.

Bashkëshorti i subjektit ka paguar 1/5 e shumave të sipërpërmendura dhe konkretisht shumën *cash* 289.988 lekë dhe 1.160.000 lekë bono privatizimi, të cilat janë blerë në tregun valutor me 6 %, duke shpenzuar vlerën 69.600 lekë.

Burimi i krijimit për pagesat e kryera për blerjen e pjesës takuese të godinës janë siguruar pjesërisht nga shuma monetare (150.000 lekë), e tërhequr në formën e *overdraftit* nga paga e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” më 13.10.2010 dhe pjesërisht nga kursimet e të ardhurave të përbashkëta të subjektit dhe bashkëshortit të saj. Vlera e objektit me sip. 115 m² që është në pronësinë e bashkëshortit të subjektit sipas kontratës nr. *** rep., datë 6.6.2011 është 1.449.788.8 lekë (1/5 e vlerës totale të objektit).

Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

8.2 ZQRPP-ja²⁷ ka konfirmuar se z. S.B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë truall me sip.180 m², nr.***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

Nga aktet e administruara nga ZVRPP-ja ka rezultuar se trashëgimtarët ligjorë të z. Z.B, në marrëveshje ndërmjet tyre kanë rënë dakord që të nënshkruajnë një aktpjesëtimi vullnetar nr. *** rep., nr. **** kol., datë 20.11.2011, për pasurinë truall me sip. 900 m², nr.***, nga kjo ndërtesë 730 m², z.k. ***, vol. **, f.**. Nga aktpjesëtimi rezulton se kanë rënë dakord që “... *S.B merr pasurinë nr. **** truall me sip. 180 m² dhe ndërtesë 115 m²...*”. Në dosje rezulton certifikata për vërtetim pronësie nr. ****, nr. pasurie ***, vol. ***, f.***, truall me sip. 900 m², nga kjo ndërtesa me sip.730 m², në emër të shtetasve I, F, V.M (B), S dhe P.B. Bashkëlidhur përgjigjes rezultojnë këto akte:

- dokumentacioni i blerjes së objektit të privatizuar “godina 2-katëshe e oficerëve”;
- certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. ***;
- kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2011. Autorizim për kalim pronësie objekti nr. *** prot., datë 20.12.2010, nga Ministria e Financave;
- Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike;
- formular pagese;
- planimetria e kateve të objektit.

Nga analizimi i akteve ka rezultuar se pasuria me nr. *** është pjesëtuar dhe nga kjo është përfituar në pronësi të bashkëshortit të subjektit pasuria me nr. ***, me pjesë takuese 1/5 e vlerës totale të objektit.

➤ Nga verifikimi i kryer nuk ngrihen dyshime për këtë pasuri.

9. Pasuria²⁸ tokë truall me sipërfaqe 2.310 m², me nr. pasurie **, z. k. ***, Pogradec, e regjistruar më 11.7.2013, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ****, datë 11.7.2013. Pjesa takuese: 1/5.**

²⁷ Me shkresën nr. **** prot., datë 2.10.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

²⁸ Bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/14) certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip. 2.310 m², nr. ***, vol.***, f.***, z.k. ***, në bashkëpronësi të shtetasve S. B, I.B, P.B, V. B (M), F.B me 1/5 pjesë secili, lëshuar në datën 11.7.2013. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimit; njoftim vendimi nr. *** prot., datë 6.1.2009, nga AKKP-ja, ku dërgohet kopja e vendimit nr. **, datë 6.1.2009, në të cilin është vendosur: “ ... kthimi i pronës truall me sip. të përgjithshme 15.460 m², të ndodhur në Pogradec në jug të rrugës Pogradec-Tushemisht të ndarë në

9.1 Burimi i krijimit

Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është përfituar me trashëgimi ligjore nga vjehri, i ndjeri Z. B, të cilit me vendimin nr. ***, datë 6.1.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Korçë, i është njohur dhe kthyer kjo pronë.

9.2 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Pogradec nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Komisionit.

ZQRPP-ja²⁹ ka konfirmuar se z. S. B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

- pasurinë truall me sip. 4.310 m², nr. ****, vol. ***, f. **, z. k. ***;
- pasurinë truall me sip. 2.000 m², nr. ***, vol. **, f. **, z. k. ***;
- pasurinë truall me sip. 2.310 m², nr. ***, vol. **, f. **, z. k. ***.

Bashkëlidhur aktet si: vendimi nr. **, datë 6.1.2009, nga AKKP-ja Qarku Korçë; vendimi nr. **, datë 1.4.2009, nga AKKP-ja për Njohjen e së Drejtës së Pronësisë Kthimin dhe Kompensimin e Pronës; vendim nr. ***, datë 17.6.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, truall me sip. 4.310 m², në bashkëpronësi të shtetasve S, I, P, V.B (M) dhe F. B me 1/5 secili.

Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar një kërkesë për ndarje pasurie me nr. ***, urdhër nr. ***, datë 11.7.2013. Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 4.310 m² ndahet në pasuritë me nr. ***, me sip. 2.000 m², vol. **, f. ** dhe pasuria nr. ***, me sip. 2.310 m², vol. **, f. **. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. **, f. **, z. k. ***, truall me sip 4.310 m². Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, truall me sip. 2.310 m², në bashkëpronësi të shtetasve S, I, P, V, B (M) dhe F,B me pjesë 1/5 secili. Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. **, f. **, truall me sip. 2.000 m², në bashkëpronësi të shtetasve S, I, P, V.B(M) dhe F. B, me pjesë 1/5 secili.

➤ **Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ngrihen dyshime për këtë pasuri.**

10. Pasuria³⁰ tokë truall me sipërfaqe 10.810 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, Pogradec, e regjistruar më 9.7.2013, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 9.7.2013. Pjesa takuese: 1/5.**

10.1 Burimi i krijimit

tri parcela: parcela F* me sip. 10.810 m² te pasuria nr. ***, z. k. ****; parcela F* me sip. 4310 m² te pasuria nr. ***, z. k. ****; parcela F* me sip. 340 m² te pasuria nr. ***, z. k.***...". Bashkëlidhur plan-vendosje e pronës.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁰ Bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip.10.810 m², nr. ***, vol. **, f. **, z. k. ***, në bashkëpronësi të shtetasve S.B, I.B, P.B, V.B(M), F.B me 1/5 pjesë secili, lëshuar më 9.7.2013. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimit; njoftim vendimi nr. *** prot., datë 6.1.2009, nga AKKP-ja, ku dërgohet kopja e vendimit nr. **, datë 6.1.2009, në të cilin është vendosur: “ ... kthimi i pronës truall me sip. të përgjithshme 15.460 m², të ndodhur në Pogradec në jug të rrugës Pogradec-Tushemisht të ndarë në tri parcela:parcela F* me sip. 10.810 m² pasuria nr. **, z. k.***; parcela F* me sip. 4310 m² te pasuria nr. **, z. k.***; parcela F* me sip. 340 m² te pasuria nr. ***, z. k.***...". Bashkëlidhur plan-vendosja e pronës (Aneks nr. 4/14).

Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është përfituar me trashëgimi ligjore nga vjehri i subjektit, i ndjeri Z.B, të cilit me vendimin nr. ***, datë 6.1.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Korçë, i është njohur dhe kthyer kjo pronë.

10.2 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Pogradec nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion dhe dokumentacion të Komisionit.

ZQRPP-ja³¹ konfirmon se z. S. B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. ****, vol. **, f. ***, truall me sip. 10.810 m², z. k. ***.

➤ **Nga verifikimi i kryer nuk ngrihen dyshime për këtë pasuri.**

11. Pasuritë³² tokë truall, ndodhur në z. k. ** Pogradec:**

- me sip. 801 m², me nr. pasurie ****;
- tokë truall me sip. 300 m², me nr. pasurie ***, të regjistruara më 23.11.2015.

11.1 Burimi i krijimit

Subjekti ka shpjeguar se këto pasuri janë të z. S.B, të cilit i janë njohur dhe kthyer këto prona me vendimin nr. **, datë 9.7.2004, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Korçë. Pjesa takuese: 100 %.

11.2 Hetimi i kryer

ZQRPP-ja³³ ka konfirmuar se z. S. B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme: pasurinë truall me sip. 801 m², me nr. ***, f. **, z. k. ***; pasuria truall me sip. 300 m², nr. ***, vol.**, f. **, z. k. ***; pasuria truall me sip. 501 m², nr. ***, vol. **, f. **, z. k. ***; pasuria truall me sip. 1.101 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k.***; pasuria truall me sip. 600 m², nr. ***, vol. **, f.***, z. k. ***; pasuria truall me sip. 300 m², nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***.

Bashkëlidhur inventari i brendshëm i dosjes për pasurinë nr. ****. Në dosje rezulton një kërkesë për ndarje pasurie nr.**** dhe urdhër për ndarje pasurie nr. **, datë 21.2.2017, për ndarjen e pasurisë nr. ***, vol. **, f. **, me sip. 801 m² në pasuritë nr. ***, vol. **, f. ***, me sip. 300 m² dhe pasurinë nr.***, vol. **f. ** me sip. 501 m², në emër të z. S.B. Certifikatë për vërtetim pronësie nr.****, pasuria nr.***, vol. ***, f. ***, z.k. *** truall me sip. 801 m², në emër të z. S.B. Harta treguese e regjistrimit për pasurinë nr.****. Harta treguese e regjistrimit për pasurinë nr.***. Kartela e pasurisë së paluajtshme e pasurisë nr. ***. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, pasuria nr.***, vol. **, f.**, truall me sip. 300 m², në emër të z. S.B. Hartë treguese e regjistrimit pasuria nr. ***. Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. pasurie ***, në emër të z. S. B.

➤ **Nga hetimi i kryer për këtë pasuri nuk rezultojnë pasaktësi dhe nuk ngrihen dyshime.**

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

³² Bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip. 801 m², nr. ***, vol. **, f. **, z.k. ***, në emër të z. S. B, lëshuar më 23.11.2015. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimit; vendim nr. **, datë 9.7.2004, i KKKP ish- Pronarëve Korçë.

³³Me shkresën nr. **** prot., datë 2.10.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

12. Pasuria tokë truall³⁴ me sipërfaqe 10.90 m², me nr. pasurie **, z. k. ****, Pogradec, e regjistruar më 14.4.2016, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 14.4.2016.**

12.1 Burimi i krijimit

Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është përfituar nga ndarja/pjesëtimi i pasurisë me nr. ***, që është përfituar me trashëgimi ligjore nga vjehri, z. Z.B, të cilit i është njohur dhe kthyer kjo pronë me vendim nr. ***, datë 6.1.2009, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Korçë. Pjesa takuese: 1/3.

12.2 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZQRPP-ja³⁵ ka konfirmuar se z. S.B ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë truall me sip. 340 m², nr. ****, vol. **, f. **, z. k. *** dhe pasurinë nr.***, vol. **, f. **, truall me sip.10.3 m², z.k. ***. Bashkëlidhur inventari i brendshëm i dosjes. Ka rezultuar se trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Z.B kanë rënë dakord në pjesëtimin e pasurisë sipas aktpjesëtimit vullnetar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.3.2016, për pasurinë nr. ****, z. k. ****, vol. **, f.***dokumentacioni i pronës. Më pas, kjo pasuri me urdhrin nr. **, datë 11.4.2016, është bërë ndarja faktike e pasurisë nr.*** me sip. 340 m² në tri pasuri të tjera me sip. 234.7 m² + 94.4 m² dhe 10.9 m². Rezultojnë: kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ****, me sip. 234 m², në emër të z. I. B; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ****, truall me sip. 94.40 m², në emër të z. P.B dhe kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ****, truall me sip. 10.90 m², në emër të shtetasve S, V.B (M) dhe F.B.

➤ **Nga verifikimi i kryer nuk ngrihen dyshime për këtë pasuri.**

13. Shuma monetare prej 1.000 euro³⁶, e siguruar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. * rep., nr. *** kol., datë 9.10.2012, nga shitja e automjetit tip “M. B” me targa PG *** B, të cilën e ka pasur në pronësi prej vitit 2005 (para martesës me bashkëshorten). Pjesa takuese: 100 %.**

Nga verifikimi i deklaramit të subjektit para fillimit të detyrës në vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar pronësinë e automjetit tip “M. B”, vit prodhimi 1992, blerë në vitin 2005. Në DPV-në e vitit 2012, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka përfituar shumë monetare prej 1.000 euro nga shitja e automjetit me targa PG **** B, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2012.

DPSHTRr-ja³⁷ ka konfirmuar automjetin me targa PG *** B, në emër të z. S.B, të cilën e ka shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2012.

➤ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.**

³⁴ Bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit truall me sip.10.90 m², nr. ****, vol. ****, f. **, z.k. ****, në emër të shtetasve S.B, F. B, V.B (M) me 1/3 pjesë secili, lëshuar më 14.4.2016. Bashkëlidhur hartë treguese e regjistrimit; njoftim vendimi nr.*** prot., datë 6.1.2009, nga AKKP-ja, ku dërgohet kopja e vendimit nr. **, datë 6.1.2009.

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2012, automjeti tip “M.B” me nr. shasie ****, me targa PG *** B, në vlerën 1.000 euro. Palë shitëse S.B, palë blerëse B.S. Bashkëlidhur leje qarkullimi mjeti nr. PG ****, në emër të shtetasit S B.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2019.

14. Automjet tip “T”³⁸ me targa AA * GR**

Vlera e deklaruar: 1.100 euro.

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të bashkëshortit.

Burimi i krijimit: kjo shumë monetare është siguruar nga çmimi i shitjes së automjetit të mëparshëm tip “M. B”, me targa PG *** B dhe diferenca nga të ardhurat e siguruar nga shitja e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, S, Tiranë (apartament me sip. 72 m²).

Deklarimi në DPV: në vitin 2012 nuk është deklaruar burim krijimi.

Mënyra e fitimit: me kontratë shitblerjeje datë 11.1.2013.

14.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja³⁹ ka konfirmuar automjetin me targa AA *** GR, në emër të z. S.B. Bashkëlidhur gjendet deklaratë nën përgjegjësi nga Bashkia Selanik datë 11.1.2013, për shitjen e automjetit tip “T. C”, me targa NZT***, nr. shasie ****, në vlerën 1.100 euro. Palë shitëse S.T, palë blerëse S.B.

14.2 Analiza financiare

Burimi i krijimit të kësaj pasurie është shitja e apartamentit në S, si dhe të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “M. B”, e cila rezulton të jetë shitur në vitin 2012.

➤ **Nga analiza financiare e kryer duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kishin mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në janar të vitit 2013, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të realizuara gjatë këtij viti.**

15. Depozitë bankare⁴⁰ në shumën 1.500.000 lekë, çelur më 19.12.2012, në “Union Bank” dega Pogradec. Pjesa takuese: 50 %

15.1 Burimi i krijimit

Të ardhura të siguruar nga shitja e pasurisë me nr. ****, z. k. ***, S, Tiranë (apartament me sip. 72 m²), referuar edhe kontratës së shitblerjes me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012, trajtuar më sipër.

Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është tërhequr pjesë - pjesë ndër vite⁴¹, duke u mbajtur në banesë dhe është depozituar sërish në “Union Bank”, më 17.2.2014 (1.440.000 lekë), është tërhequr sërish në vitin 2014 dhe është depozituar më 19.3.2015 sërish në “Union Bank”, duke u konvertuar në valutën euro, në shumën 10.500 euro. Më pas, shuma prej 10.495 euro, sipas

³⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: deklaratë nën përgjegjësi, nga Bashkia Selanik datë 11.1.2013, për shitjen e automjetit tip “T. C”, me targa NZT***, me nr. shasie *****, në vlerën 1.100 euro. Palë shitëse S.T, palë blerëse S.B; leje qarkullimi nr. *****, për automjetin tip “T C”, me targa AA *** GR, nr. shasie ****, në emër të z. S.B. Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA *** GR.

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2019.

⁴⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Union Bank”, datë 11.1.2017, ku konfirmohet tërheqje nga llogaria më 1.2.2016 e shumës 9.000 euro.

⁴¹ Subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar ndër vite gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, duke pasqyruar gjendjen e likuiditeteve të mbetura në fund të çdo viti, si dhe shumat e depozituara në llogari bankare.

informacionit të administruar nga banka, është tërhequr nga “Union Bank” më 24.3.2015 dhe ka qenë gjendje *cash* në banesë deri në datën 25.1.2016, kur është depozituar sërish në “Union Bank” e pakësuar në shumën 9.300 euro. Më pas, në datën 1.2.2016 është tërhequr nga kjo llogari shuma prej 9.000 euro dhe në datën 18.2.2016 është tërhequr nga banka shuma prej 299 euro, duke e bërë të mundur kështu tërheqjen e të gjithë shumës nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Këto veprime dokumentohen në *statement* e printuar më 11.1.2017, nga “Union Bank”.

Burimi i deklaruar i këtyre të ardhurave është shitja e pasurisë me nr. ****, z. k. ***, S, Tiranë (apartament me sip. 72 m²), referuar edhe kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2012

Subjekti, në deklaratën *Vetting* saktëson se: “Aktualisht në momentin e këtij deklarimi shuma monetare prej 9.000 euro, e tërhequr nga ‘Union Bank’, në datën 18.2.2016, gjendet *cash* në banesë. Shuma 1.500.000 lekë e tërhequr më 18.2.2016”.

✓ **Referuar analizës financiare në fund të këtij dokumenti duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi për krijimin e kësaj shume.**

16. Gjetje të tjera nga Komisioni

Nga deklaratimet e subjektit ka rezultuar një kontratë huaje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2016, sipas së cilës z. S.B ka marrë një hua në shumën 26.000 euro, nga shtetasi F.T, shumë kjo e cila ka kaluar nëpërmjet llogarisë bankare të noterit E.B. Afati i kthimit të kësaj shume do të jetë data 11.2.2017.

Në datën 15.2.2016, në llogarinë e shtetasit S.B në bankën “Societe General Albania” është depozituar shuma prej 26.000 euro nga llogaria e noterit me përshkrimin “likuidim sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 12.2.2016, huadhënës F.T”. Shuma prej 26.000 euro është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit po në datën 15.2.2016. Kjo llogari rezulton të jetë mbyllur më 18.2.2016 dhe pas kësaj date nuk ka më veprime në këtë llogari.

Në lidhje me kthimin e huas është lëshuar një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr.*** kol., datë 14.2.2017, sipas së cilës z. F. T deklaron se ka marrë plotësisht të gjithë huan në shumën 26.000 euro, dhënë z. S.B.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2019, ka shpjeguar se: “Huaja në shumën 26.000 euro, marrë nga shtetasi F.T nëpërmjet kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2016, është marrë nga bashkëshorti S.B për qëllime investimi së bashku me familjarët e tij (nënë dhe motrën). Duke qenë bashkëpronarë të disa pasurive të paluajtshme, bashkëshorti S.B dhe familjarët e tij, nëna F.B dhe motra V.M kanë parashikuar të investojnë te këto pasuri për krijimin e kushteve për aktivitet privat në qytetin e Pogradecit. Duke mos u dakordësuar për kryerjen e këtij investimi, shuma e huas iu kthye huadhënësit F.T, veprim ky i vërtetuar me dokumentin deklarate noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2017.

Në lidhje me mundësinë për burimin e ligjshëm të huas, të dhënë nga shtetasi F.T, sqarohet se shtetasi F. T është ortak i vetëm i subjektit 'F. F.T' sh.p.k., themeluar në datën 17.12.1994 me objekt aktiviteti 'tregti të artikujve industrialë, ushqimorë me shumicë e pakicë, shërbim në sferën e ushqimit social'. Referuar pasqyrave financiare të subjektit 'F. F.T' sh.p.k. rezulton se ky subjekt në vitin 2015 ka deklaruar në organet tatimore fitim në shumën 1.424.646 lekë, ndërsa në vitin 2016 ka deklaruar fitim në shumën 2.790.230 lekë”.

Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka depozituar dokumentacion provues:

1. kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2016;
2. deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2017;
3. ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë “F. F.T” sh.p.k. dhe pasqyrat financiare të saj për vitin 2016.

16.1 Analizimi i fakteve

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se shtetasi F.T është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “F. F.T” sh.p.k., themeluar më 17.12.1994 dhe i regjistruar në QKB, në datën 24.1.2003, me objekt të aktivitetit “tregti të artikujve industrialë, ushqimorë me shumicë e pakicë, shërbim në sferën e ushqimit social.”

Sipas bilancit të vënë në dispozicion nga subjekti në përgjigje të pyetësorit të dytë rezulton se shoqëria tregtare “F. F.T” sh.p.k. ka pasur fitim *neto* në fund të vitit 2015, në shumën 1.424.646 lekë dhe në fund të vitit 2016 ka pasur fitim *neto* në shumën 2.790.230 lekë.

- Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, duket se huaja me shumën 26.000 euro nuk është pasqyruar në pasqyrën financiare të vitit 2016 të shoqërisë tregtare “F.F.T” sh.p.k. (zëri huadhënie nuk ekziston në bilancin e kësaj shoqërie).
- Nga këqyrja e dokumentacionit duket se shoqëria “F. F.T” sh.p.k. nuk ka shpërndarë dividend për vitin 2015, si dhe nuk na ka vënë në dispozicion të dhëna nëse shtetasi F. T disponon të ardhura nga paga që justifikojnë huan prej 26.000 euro.

Komisioni ka hetuar për konfliktin e interesit në lidhje me huadhënësin, duke kërkuar informacion në Prokurorinë e Përgjithshme, nëse shtetasi F.T rezulton të jenë apo të kenë qenë si “person nën hetim” apo “nën hetim pasuror”, apo nëse ndaj tij ka pasur procedime penale (pavarësisht akuzës), në regjistrat e Prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

Prokuroria e Përgjithshme⁴² ka bashkëlidhur informacionin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm.

Nga përgjigjet e marra nga Prokuroria e Përgjithshme nuk rezultuan të dhëna në lidhje me huadhënësin F. T, për sa ka kërkuar Komisioni.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 30.4.2020.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike, ndër vite, ka rezultuar se kjo hua është deklaruar në DPV-në e vitit 2016 në deklarin e bashkëshortit të subjektit te rubrika e shpenzimeve të deklarueshme, te të dhënat konfidenciale bashkëshorti i subjektit ndër të tjerat ka deklaruar se: *“Shuma monetare prej 26.000 euro, e marrë hua nga shtetasi F. T në vitin 2016, referuar kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2016, hua kjo e kthyer plotësisht në datën 14.2.2017, referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2017.”*

- Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje nuk u provua burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit për huan me shumën 26.000 euro.

16.2 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësimet e rezultateve të hetimit të datës 25.9.2020, ka shpjeguar se huaja në shumën 26.000 euro është marrë nga shtetasi F. T nëpërmjet kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2016, prej bashkëshortit S.B për qëllime investimi së bashku me familjarët e tij (nënë dhe motrën) në pasuritë e paluajtshme. Të gjitha veprimet e kryera me këtë hua janë realizuar me akte noteriale në kohë reale kur janë kryer veprimet.

Kjo shumë monetare nuk është përdorur nga bashkëshorti i subjektit apo familjarët e tij (nëna dhe motra), pasi nuk kanë rënë dakord për të investuar te pasuritë e tyre të paluajtshme dhe i është kthyer shtetasi F.T brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin noterial. Si rrjedhojë, duke mos e përdorur këtë shumë, bashkëshorti nuk ka përfutuar asnjë të drejtë prej saj dhe nuk ka krijuar asnjë pasuri prej kësaj shume të marrë hua. Kjo shumë nuk është përdorur si burim për krijimin e asnjë pasurie as për subjektin dhe as për bashkëshortin e saj.

Subjekti ka shpjeguar se duke pasur si qëllim respektimin e ligjit dhe plotësimin korrekt të deklaratave periodike vjetore, duke mos fshehur asgjë, është deklaruar huaja nga bashkëshorti i saj, e cila realisht nuk ka shërbyer për asnjë shtim pasurie për të apo bashkëshortin dhe as për ndonjë financim aktiviteti apo investim në përfitim të tyre apo ndonjë personi tjetër. Pra, subjekti ka përmbushur nga ana formale detyrimin ligjor për deklarin e kësaj huaje, si dhe kthimin mbrapsht të saj.

Në lidhje me huadhënësin dhe burimin e krijimit subjekti ka shpjeguar se shtetasi F. T është ortak i vetëm i shoqërisë “F.F.T” sh.p.k., themeluar në datën 17.12.1994 me objekt aktiviteti “tregti të artikujve industrialë, ushqimorë me shumicë e pakicë, shërbim në sferën e ushqimit social” dhe, si rrjedhojë e ushtrimit të këtij aktiviteti privat për më shumë se 20 vjet deri në momentin e dhënies së kësaj huaje, ka pasur mundësi reale të krijojë të ardhura të ligjshme.

Nga shtetasi F. T i janë vënë në dispozicion disa akte shkresore si pasqyrat financiare për vitet 2008 – 2016 të shoqërisë “F.F.T” sh.p.k., vendimet e ortakut të vetëm të kësaj shoqërie për vitet 2010 – 2018, vërtetim datë 21.9.2020, lëshuar nga shoqëria “F.F.T”, sipas të cilave rezulton e provuar se:

- vetëm për periudhën 2008 – 2016 kjo shoqëri ka realizuar shumën prej 12.058.952 lekësh fitim *neto*;
- për vitet 2011 – 2016 ka ndarë dividendë në shumën totale 2.370.000 lekë;
- për periudhën 2009 – 2016 shtetasi F.T ka përfituar të ardhura nga paga *neto* e administratorit në shumën 2.573.368 lekë.

Referuar shkresës nr. *** prot., datë 25.9.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, si dhe dokumentacionit ligjor të vendosur në dispozicion nga tatimpaguesi “F. F.T” sh.p.k. me NIPT K***J rezulton se nga viti 2011 dhe në vazhdim, për këtë tatimpagues, është paguar në mënyrë të rregullt detyrimi për tatimin në burim për dividendin e tërhequr.

Gjithashtu, referuar po kësaj shkrese nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë rezulton se z. F.T, në cilësinë e administratorit të shoqërisë është trajtuar me pagë të deklaruar pranë organeve përkatëse.

Bazuar në dokumentacionin bankar të vënë në dispozicion nga z. F.T, subjekti ka depozituar llogaritë rrjedhëse bankare të këtij shtetasi, ku provohen transaksione dhe lëvizje të ndryshme bankare të kryera prej tij nga viti 2010 e në vijim. Nëse i referohemi depozitave bankare sipas dokumentit *statement*, lëshuar nga “Tirana Bank” shtetasi F.T dhe bashkëshortja e tij kanë pasur llogari bankare në këtë bankë dhe vetëm në shtator të vitit 2013 ka tërhequr shumën monetare 3.389.870 lekë, ndërsa bashkëshortja e tij shumën prej 2.773.560 lekësh, ndërkohë që ka kryer edhe tërheqje të mëparshme në shuma të tjera të konsiderueshme.

Gjithashtu, në *statementet* bankare reflektohen edhe interesat të kredituara nga banka për depozita me afat që ky shtetas ka pasur pranë këtyre bankave, të cilat Komisioni do të duhet t’i marrë në konsideratë.

Subjekti ka shpjeguar se Komisioni duhet të ketë në konsideratë edhe faktin se huadhënësi, duke ushtruar aktivitetin e tregtimit të artikujve ushqimorë (duke pasur disa njësi të tregtimit të artikujve ushqimorë në qytet), shpenzimet minimale të tij janë më të vogla se ato të një personi tjetër që realizon jetesën e përditshme duke i blerë ato dhe jo nga shfrytëzimi i artikujve që tregton vetë (kostoja e ushqimit).

16.3 Analiza ligjore

Komisioni, në vlerësim të rrethanave të deklaruara nga subjekti dhe fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar saktë huan e marrë të huadhënësi F. T, si dhe shlyerjen/kthimin mbrapsht të saj.

Trupi gjykues, duke vlerësuar dokumentacionin ligjor të depozituar nga subjekti, si dhe nga huadhënësi

- si pasqyrat financiare për vitet 2008 – 2016, të shoqërisë “F.F.T” sh.p.k., vendimet e ortakut të vetëm të shoqërisë për vitet 2010 – 2018, vërtetim datë 21.9.2020, lëshuar nga kjo shoqëri, sipas të cilave rezulton e provuar se:

- vetëm për periudhën 2008 – 2016 ky subjekt ka realizuar shumën 12.058.952 lekë fitim *neto*;
- për vitet 2011 – 2016 ka ndarë dividendë në shumën totale 2.370.000 lekë;

- për periudhën 2009 – 2016 shtetasi F.T ka përfituar të ardhura nga paga *neto* e administratorit në shumën 2.573.368 lekë.

Referuar shkresës nr. ***, datë 25.9.2020, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, si dhe dokumentacionit ligjor të vendosur në dispozicion nga tatimpaguesi “F. F.T” sh.p.k., me NIPT K***J rezulton se nga viti 2011 dhe në vazhdim për këtë tatimpagues është paguar në mënyrë të rregullt detyrimi për tatimin në burim për dividendin e tërhequr.

Gjithashtu, referuar po kësaj shkrese nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka rezultuar se z. F. T, në cilësinë e administratorit të shoqërisë është trajtuar me pagë të deklaruar pranë organeve përkatëse.

Bazuar në dokumentacionin bankar të vënë në dispozicion nga z. F.T, në llogaritë rrjedhëse bankare të këtij shtetasi, rezultojnë transaksione dhe lëvizje të ndryshme bankare të kryera prej tij nga viti 2010 e në vijim. Referuar depozitave bankare sipas dokumentit *statement*, lëshuar nga “Tirana Bank”, shtetasi F. T dhe bashkëshortja e tij kanë pasur llogari bankare në këtë bankë dhe vetëm në shtator të vitit 2013 ka tërhequr shumën monetare prej 3.389.870 lekësh, ndërsa bashkëshortja e tij shumën 2.773.560 lekë, ndërkohë që ka kryer edhe tërheqje të mëparshme në shuma të tjera të konsiderueshme.

Me gjithë arsyetimin sa më sipër, shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti, rezulton se huadhënësi ka gjeneruar të ardhura të ligjshme që mund të mjaftonin për huan, por Komisioni ka çmuar të panevojshme kryerjen e një analize të thelluar mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet e huadhënësit: (i) për faktin se subjekti ka provuar kthimin e huas me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 14.2.2017; (ii) për faktin se nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të viteve 2016 dhe 2017 ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar investim të kryer, pasi huaja është marrë me qëllim investimi dhe nuk ka shërbyer si burim krijimi për ndonjë pasuri apo si investim. Për këtë arsye, referuar pikës 2 të nenit D, të Kushtetutës, ku parashikohet se: “*Subjekti duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave..*”, në këtë rast, subjekti nuk ka krijuar asnjë pasuri dhe, për pasojë, nuk ka as detyrim që të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë.

Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj huaje dhe shlyerjen e saj.

17. Analiza përmbledhëse financiare për periudhën 2008 – 2016

VITET	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO	TE ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
2008	27 139	-	27 139	983 476	416 880	539 456
2009	-22 110	-	- 22 110	1 127 746	417 796	732 060
2010	1 832 502	-	1 832 502	2 435 700	620 096	- 16 898
2011	-39 029	-	- 39 029	1 657 620	582 789	1 113 860
2012	3 512 823	-	3 512 823	6 759 630	1 588 531	1 658 276
2013	-1 131 378	-	- 1 131 378	1 378 088	933 732	1 575 734
2014	-282 705	-	- 282 705	1 782 922	1 238 089	827 538
2015	-462 505	-	- 462 505	1 656 632	1 267 227	851 910
2016	-236 109	3 517 020	-3 753 129	1 664 397	1 328 410	4 089 116

Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2008 – 2016 ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të, kanë pasur burime të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të përballuar shpenzimet ndër vite.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport⁴³ në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Dorina Bejko.

- **Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit lidhur me figurën, subjekti ka plotësuar me vërtetësi këtë formular.**

Konkluzion për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshillit i Lartë i Prokurorisë⁴⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij); dhe
- denoncimeve të paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;

⁴³ Raport nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 24.4.2019.

⁴⁴ Sipas shkresës nr. ** prot., datë 12.6.2019.

Ky raport është mbështetur në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë këtë formular dhe të paraqitura prej saj;
- 2) pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, etj.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe të dhënat nga burimet arkivore në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga raporti hartuar nga KLP-ja ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Dorina Bejko tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në aktet e paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Në dokumentet ligjore të vëzhguara është analizuar norma penale dhe procedurale penale e zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurores Dorina Bejko, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj, në këto vite.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurorja. Rezulton se prokurorja vë në pah përfundime lidhur me elementë konkretë të figurës së veprës penale objekt hetimi, kur arrin në përfundimin se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale për të cilën është akuzuar.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi, në periudhën e rivlerësimi 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Nga të dhënat statistikore rezulton se prokurorja Dorina Bejko, në periudhën e rivlerësimi, ka trajtuar gjithsej 574 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër) materiale.

Në periudhën e rivlerësimi, subjekti Dorina Bejko është caktuar si prokurore për ushtrimin e funksioneve në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale. Si pjesë e ushtrimit të detyrës në këtë seksion, prokurorja ka nxjerrë gjithsej 1139 (njëmijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) urdhra ekzekutimi.

Subjekti i rivlerësimi, znj. Dorina Bejko, ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve ligjore, konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune me profil të larmishëm gjatë periudhës së rivlerësimi.

Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimi, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e saj për çështjen në gjykim. Vendimi i mosfillimit i procedimit penal është marrë brenda afatit 30-ditor të parashikuar në Udhëzim nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimi, prokurorja Dorina Bejko, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimi në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokuroren Dorina Bejko nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Dorina Bejko, dhe nga dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Dorina Bejko, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit është deklaruar se është angazhuar në 10 aktivitete profesionale (seminare) të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, ka qenë pjesëmarrës në disa aktivitete të zhvilluara.

C/1 RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit nr. ** prot., datë 12.6.2019, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLP-ja;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe i pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin e tij, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

✓ **Trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të grupit të punës, nuk gjeti indice, apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale.**

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit u paraqitën dy denoncime nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit, përkatësisht:

1. **Denoncim nr. *** rep., datë 20.3.2018**, i depozituar nga znj. A. H.

Denoncuesja ka paraqitur pretendime për 2 subjekte rivlerësimi dhe pretendon se këta dy prokurorë nuk kanë kryer hetimet e duhura për vrasjen e djalit të saj, e cila edhe sot e kësaj dite ka ngelur enigmë. Denoncuesja ka pretenduar se prokuroria ka manipuluar provat, që të mbulohej krimi në këmbim të parave.

Denoncuesja ka depozituar vendimin me nr. ***, datë 26.11.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë, nga i cili rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 9.7.2015, ka deklaruar fajtorë 2 shtetas dhe ka vendosur për shtetasin me iniciale E. B., akuzuar për veprën penale “vrasje me dashje”, dënimin me 12 vjet burgim. I akuzuari tjetër për veprën penale “moskallzim i krimit”, me inicialet R. Z., është dënuar me 1 vit e katër muaj burg. Pas ankimit të vendimit nga të pandehurit, Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

✓ Për sa i përket këtij denoncimi nuk rezultojnë *indicie* për ndonjë shkelje nga subjekti i rivlerësimit.

2. **Denoncim nr. *** rep., datë 22.2.2019**, depozituar nga znj. E.R. Denoncuesja ka paraqitur pretendime për 2 subjekte rivlerësimi, duke pretenduar se subjekti Dorina Bejko, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në bashkëpunim me drejtuesin e kësaj prokurorie kanë vënë organin e akuzës në shërbim të personave të tretë me interesa në çështje penale.

Nga aktet e depozituar nga denoncuesja, rezulton se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ka regjistruar procedimin penal nr. **, datë 16.9.2015, në ngarkim të të pandehurit S R (bashkëshorti i denoncueses), i cili ishte akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, kallëzuar nga vëllai i tij, shtetasi A.R. Çështja i është caktuar prokurores Dorina Bejko, e cila në përfundim të hetimeve ka vendosur ta dërgojë çështjen për gjykim, duke u akuzuar i pandehuri S. R, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

Denoncuesja pretendon se prokurorja e çështjes në fjalë ka kryer shkelje procedurale dhe materiale të ligjit penal, në hetimin e kryer për këtë çështje, shpërdorim detyre si dhe falsifikim dokumentacioni.

Denoncuesja shpjegon se ka paraqitur kallëzim penal ndaj prokurores Dorina Bejko, duke e kallëzuar për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim dokumentesh” në formën e përdorimit të dokumentit të falsifikuar, si dhe shtetasin A.R për kryerjen e veprës penale

“falsifikim të dokumenteve”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi të mosfillojë procedimin penal në lidhje me kallëzimin ndaj prokurores me nr. ***, datë 18.4.2018.

Vendimin e mosfillimit të procedimit penal ndaj prokurores së çështjes, denoncuesja e ka ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo e fundit me vendimin nr. ****, datë 26.6.2018, ka rrëzuar kërkesën e denoncueses. Brenda afatit, denoncuesja e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 23.8.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga shtetasja E.R ndaj vendimit nr. ***, datë 26.6.2018, si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Kundër këtij vendimi denoncuesja ka bërë rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

Rezulton që pretendimet e denoncueses, për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit, të jenë vlerësuar nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Çështja ka përfunduar me mosfillimin e procedimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, sipas pretendimeve të denoncueses, kjo çështje është ende në shqyrtim dhe e pazgjidhur. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës “*Vlerësimi i aftësive profesionale nuk mund të shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*”.

Nga shqyrtimi i parashtrimeve në denoncime, si dhe nga dokumentacioni i administruar, u vërejt se rezultuan shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesja, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e depozituara ka sjellë në vëmendje të Komisionit se në momentin e depozitimit të pretendimeve të saj, çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Për këtë shkak, Komisioni arsyeton referuar pikës 2, të nenit E, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve në gjykim.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në cilësinë e relatores së çështjes, nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurores Dorina Bejko dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficiente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, propozon për kriterin profesional vlerësimin “e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Dorina Bejko, prokurore/drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.11.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha